



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018



Plani i punës për vitin **2018**



©Akademia e Drejtësisë 2018,

Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja
e këtij materiali nuk mund të rishtypet,
shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme
tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet
ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të
Akademisë së Drejtësisë.

**Plani i punës është miratuar nga
Këshilli Drejtues i Akademisë me datën 17.01.2018**

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	6
1.1 Misioni dhe vizioni	9
1.2 Funksionet e Akademisë	9
1.3 Objektivat strategjike	10
2. Organet e Akademisë së Drejtësisë	11
2.1 Këshilli Drejtues	11
2.2 Këshilli Programor	13
3. Programi i trajnimeve për vitin 2018	14
3.1 Programi i trajnimit të vazhdueshëm (PTV)	15
3.2 Trajnimet e detyrueshme për gjyqtarët	16
3.3 Programi i trajnimit fillestar (PTF)	16
3.4 Trajnimet për avancim (TA)	17
3.5 Programi për hulumtime dhe publikime (PHP)	17
3.6 Biblioteka	17
3.7 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive	17
3.8 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	18
3.9 Trajnimet për avokat shtetërorë, avokatë dhe profesionet tjera të lira	18
3.10 Trajnim për Trajnues (TiT)	18
3.11 Mësimi në distancë (e-learning)	19
3.12 Menaxhimi i të dhënave	19
4. Administrata, financat dhe shërbimet e përgjithshme	20
4.1 Burimet njerëzore	21
4.2 Financat	21
4.3 Prokurimi	22
4.4 Shërbime të përgjithshme dhe teknologji informative	22
5. Bashkëpunimi me partner strategjik	23
6. Plani për zbatimin e Planit të Punës së AD-së	25
7. Sfidat dhe rreziqet	33
8. Përfundimi	35

1. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë (24 shkurt 2017), Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) është transformuar në Akademi të Drejtësisë, dhe i njihet statusi i trashëgimitarit juridik të IGJK-së.

Me këtë ligji, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur, funksionet kryesore të së cilës janë, hartimi i programit trajnues dhe organizimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnimin për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira, zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime, kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore, kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor e prokurorial dhe profesioneve të lira, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

AD organizon trajnime me standarde të larta profesionale dhe me metoda efektive në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve të cilat kanë në fokus mandatin ligjor dhe përfituesit e AD-së.

Organet kryesore të AD-së janë Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, përgjegjësit e të cilëve janë të përcaktuar me ligj.

Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të AD-së, përveç Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor si organ profesional dhe këshillëdhënës përfshihet, Zyra e Drejtorit të AD-së, Departamenti i Programeve dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

Aktualisht AD realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Plani i punës së Akademisë për vitin 2018, përmban aktivitetet që Akademia planifikon t'i realizoj në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe profesionistëve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor e prokurorial, si dhe prioritetet e Akademisë, me qëllim të zhvillimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe efikas.

Plani i punës për vitin 2018, përfshinë trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, trajnime për trajnues, programe orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët

e avancuar, trajnime fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, trajnime për menaxhmentin, dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Gjithashtu pjesë e programit të punës së Akademisë janë edhe aktivitetet menaxhuese dhe të administrimit të përgjithshëm të punës së Akademisë.

1.1 Misioni dhe vizioni

Akademia e Drejtësisë fokusohet në zhvillimin dhe ofrimin e programeve bashkëkohore trajnuese, në ngritje e kapaciteteve të bartësve të funksioneve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial por jo vetëm, për zbatim të standardeve më të larta të performancës profesionale dhe etike.

Misioni i Akademisë është të ofrojë trajnime cilësore, veprimtari kërkimore dhe botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si institucion modern i trajnimit dhe kontribues në ngritjen profesionalizmit, pavarësisë, paanshmërisë, efikasitetit dhe besimit të publikut.

Vizioni i Akademisë është, të avancohet më tej si një institucion profesional në ofrimin e programeve trajnuese dhe formave tjera të mbështetjes për sistemin gjyqësor dhe prokurorial profesional të pavarur dhe të paanshëm.

1.2 Funkcionet e Akademisë

Akademia kryen funksionet e parapara si në vijim:

- harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
- organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;

- 1.6. mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikatat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;

1.3 Objektivat strategjike

Akademia e Drejtësisë është në proces të hartimit të Planit Strategjik i cili do të reflektojë ndryshimet legjislative dhe qëllimin e transformimit të Institutit Gjyqësor në Akademi të Drejtësisë.

Për këtë arsye Akademia e Drejtësisë konsideron se hartimi i objektivave strategjike për vitin 2018 është më se i nevojshëm dhe mundëson zbatimin e aktiviteteve përmes planeve konkrete të veprimit që do të kryhen gjatë vitit 2018.

Si objektiva strategjike për 2018, AD përcakton:

- Përmbyllja e procesit të transformimit nga IGJK në AD,
- Hartimi dhe zbatimi i programeve trajnuese,
- Transparenca dhe gjithë përfshirja,
- Mundësimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe kategorive tjera përfituese që në mënyrë efektive dhe profesionale të kryejnë detyrat e tyre përmes trajnimeve të orientuara në punë dhe të bazuara në kompetenca,
- Zhvillimi i hulumtimeve dhe botimeve në fushën ligjore,
- Ofrimi i trajnime për shkathtësi të TI, dhe mësimin nga distanca për menaxhim dhe funksionim efektiv të sistemit të drejtësisë,
- Zbatimi i standardeve për menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit,
- Zhvillimi i akteve normative dhe dokumenteve të punës,
- Zhvillimi i kapaciteteve administrative dhe resurseve njerëzore,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar,
- Programet praktike brenda dhe jashtë vendit.

Akademia e Drejtësisë do të zhvilloj plane veprimi për zbatimin e objektivave strategjike për vitin 2018.

2. Organet e Akademisë së Drejtësisë

2.1 Këshilli Drejtues

Ligji Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë, themelon Akademinë e Drejtësisë dhe rregullon statusin, funksionet dhe organet e saj, mënyrën dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin.

Ligji po përcakton Këshillin Drejtues, Këshillin Programor dhe Drejtorin Ekzekutiv, si organet më të larta drejtuese.

Këshilli Drejtues i Akademisë ka një përfaqësim të institucioneve të drejtësisë dhe qeverisë përfshirë edhe përfaqësimin etnik. Kjo përbërje siguron një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të drejtë të interesave të akterëve të drejtësisë në Kosovë dhe garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e Akademisë në funksion të interesit më të mirë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend.

Këshilli Drejtues i Akademisë, përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio. Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit, ndërsa shtatë (7) anëtarë, nga institucionet e mëposhtme:

- tre (3) anëtarë të emëruar nga KGJK, dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) gjyqtar nga Gjykata e Apelit dhe një (1) anëtar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- tre (3) anëtarë të emëruar nga KPK, dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) anëtar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- një (1) anëtar i emëruar nga Ministri i Drejtësisë;

Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues janë të përcaktuara me ligj;

- miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- miratimi i projektbudgetit të Akademisë;
- miratimi i strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- miratimi i listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- mbikëqyrja e punës së Akademisë;
- përcaktimi i prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me

- KGJK-në dhe KPK-në;
- zgjedhja dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv;
- emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Programor;
- kryerja e punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

2.2 Këshilli Programor

Këshilli Programor është organ profesional i cili angazhohet për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia.

Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të drejtorit ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Për punën e tij Këshilli Programor i raporton Këshillit Drejtues

Këshilli Programor në bazë të ligjit ka këto kompetenca:

- harton propozim programin e trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK në dhe KPK-në;
- përcjell realizimin e programeve dhe suksesin e tyre;
- jep orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- jep mendim, për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- jep këshilla, propozimeve dhe sugjerimeve, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

3. Programi i trajnimeve për vitin 2018

Programi i Trajnimeve për vitin 2018 mbulon fushat kryesore të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë, i cili do të jetë bazë për hartimin e kurrikulave dhe organizimin e trajnimeve për këtë periudhë.

Ky program rezulton nga procesi gjithëpërfshirës i vlerësimit të nevojave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë. Prosesi ka përfshirë rekomandimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndryshimet legjislative, strategjitë e zbatueshme që prekin fushën e gjyqësorit, kërkesat e KGJK dhe KPK, raportet dhe rekomandimet e ndryshme të organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe dokumente tjera strategjike për zhvillimin e sistemit gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efektiv dhe efikas.

Struktura e trajnimeve për vitin 2018 do të jetë si më poshtë:

- Kompetencat profesionale
- Kompetencat interdisiplinare

Komponentët kryesore të Programit të Trajnimeve janë:

- Trajnimet e vazhdueshme
- Trajnimet fillestare
- Trajnimet për avancim
- Hulumtimet dhe publikimet
- Trajnimet për trajnues
- Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive
- Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
- Trajnimet nga distanca

Varësisht dinamikës së zhvillimeve të reja, plani i punës dhe programet e trajnimeve do të rishikohen dhe plotësohen duke ju përshtatur këtyre zhvillimeve dhe nevojave të përfituesve të trajnimeve.

3.1 Programi i trajnimit të vazhdueshëm (PTV)

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm është program trajnues i cili është paraparë me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe përfshinë organizimin e trajnimeve si dhe aktiviteteve të ndryshme për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Qëllimi i trajnimeve të vazhdueshme është ngritja e kapaciteteve profesionale, etike dhe praktike për ushtrimin e funksioneve të gjyqësorit. Trajnimet e vazhdueshme gjithashtu kontribuojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e

gjqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor. Struktura e programit të trajnimeve të vazhdueshme përmban tema të karakterit kryesisht profesional duke i përfshirë edhe temat të karakterit ndër personal.

Në aspektin profesional përfshihen lëmit si: e drejta penale, e drejta civile, drejtësia për fëmijë, e drejta komerciale dhe financiare, e drejta administrative, e drejta evropiane dhe ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe mos - diskriminim, nga lëmia e kundërvajtjeve. Për të gjitha lëmit do të përfshihet aspekti material dhe procedural duke përfshirë edhe ekzekutimin e sanksioneve penale si dhe aspektin civil dhe penal te drejtësia për të mitur.

3.2 Trajnimet e detyrueshme për gjyqtarët

Akademia e Drejtësisë gjatë viti 2018 do të angazhohet për krijimin e mekanizmave për zbatimin e trajnimeve të detyrueshme siç është e përcaktuar me ligj, aktet normative dhe në bazë të kërkesave të KGJK dhe KPK. Për shkak se këto trajnime janë risi në punën e Akademisë, nevojitet një koordinim shtesë ndërinstytucional dhe resurse adekuate për realizimin e këtyre trajnimeve.

3.3 Programi i trajnimit fillestar (PTF)

Në kuadër të mandatit ligjor Akademia e Drejtësisë zhvillon edhe aktivitete nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF), i cili fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të profesionistëve që hyjnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit të shtetit.

Objektivë kryesore në kuadër të PTF-së, Akademia ka përcaktuar zhvillimin e kompetencave profesionale, personale dhe interdisiplinare si dhe zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar zgjatë 12 muaj dhe është i strukturuar sipas modelit të kombinuar teorik dhe praktik.

Pjesa teorike përfshinë trajnimin teorik i cili përmban përveç moduleve profesionale dhe karakterit inderdisiplinar edhe shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj. Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktik zhvillohet në gjykata/prokurorit përkatëse ku ata janë emëruar si dhe trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhën me punën e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit.

3.4 Trajnimet për avancim (TA)

Akademia organizon trajnime për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që janë avancuar në detyrë qoftë në departamente brenda të njëjtit nivel apo edhe në nivele më të larta.

Qëllimi i TA-së është, që përmes ofrimit të programeve orientuese, tu ofrohet mbështetja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në ngritjen dhe aftësimin e tyre profesional përkritazi me përgjegjësitë e reja të funksionit dhe nivelit në të cilin kanë kaluar.

3.5 Programi për hulumtime dhe publikime (PHP)

Akademia e Drejtësisë në përmbushje të mandatit të saj ligjor për zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, kryen edhe analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese në përmbushje të nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira.

Gjatë vitit 2018, Programi për Hulumtime dhe Publikime do të fokusohet në komponentët e saj siç janë: hulumtimet, publikimet dhe qasja në burimet ligjore përmes bibliotekës së Akademisë.

3.6 Biblioteka

Biblioteka e AD-së ofron resurse dhe shërbime gjithëpërfshirëse në mbështetje të hulumtimit, trajnimeve, dhe nevojave të mësimin për përfituesit e AD-së në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare.

Biblioteka e AD-së ofron rreth 2000 publikime ligjore dhe revista nga vende të ndryshme në të gjitha temat ligjore. Materialet që përmban kjo bibliotekë gjenden në gjuhën shqipe, serbe, angleze, gjermane dhe në gjuhë tjera.

Biblioteka ligjore operon përmes platformës elektronike dhe data bazave të abonuar të cilat janë të pasura me literaturë juridike vendore dhe ndërkombëtare.

3.7 Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive

Menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive janë faktorë kyç në mbarëvajtjen e proceseve brenda gjykatave dhe prokurorive që ata drejtojnë. Për udhëheqje të drejtë dhe efikase të gjykatave dhe prokurorive është e rëndësishme ngritja

e vazhdueshme e kapaciteteve të kryetarëve, kryeprokurorëve, gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve, udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve që ata drejtojnë. Kjo me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, qëndrueshmërisë dhe rritjes së efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori.

Në funksion të kësaj, Akademia e Drejtësisë do të organizojë trajnime specifike për kategoritë e theksuara më lartë në përputhje me politikat dhe standardet e aplikueshme, dhe me kërkesat ligjore.

3.8 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mandatin e saj ka përgjegjësi edhe për organizimin e kurseve trajnuese edhe për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive. Stafit administrativ i gjykatave dhe prokurorive janë faktorë kyç në procesin e punës në gjykata dhe prokurori dhe përbëhen nga kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative, detyrave të punës si dhe kompetencave specifike.

3.9 Trajnimet për avokat shtetërorë, avokatë dhe profesionet tjera të lira

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial mund të organizojë trajnime të vazhdueshme edhe për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente. Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë do të krijojë strukturën organizative të nevojshme dhe mekanizmat tjerë përcjellës për t'iu përgjigjur kërkesave të institucioneve kompetente për zbatimin e këtyre trajnimeve.

3.10 Trajnim për Trajnues (TiT)

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, trajnuesit janë të detyruar të marrin pjesë në programet për trajnim të trajnuesve duke pasur parasysh se ata janë faktorë kyç për cilësinë dhe zbatimin e programeve trajnuese.

Përmes programit për trajnimin e trajnuesve, Akademia e Drejtësisë do të ofrojë nivelin më të lartë të trajnimit teorik dhe praktik, duke krijuar dhe mbajtur trajnues të përditësuar me metodologjitë trajnuese bashkëkohore, me qëllim të realizimit të trajnimeve sa më atraktive, praktike dhe efektive për të përmbushur synimet e përcaktuara në programin trajnues.

3.11 Mësimi në distancë (e-learning)

Mësimi në distancë është të mësuarit interaktiv nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, jashtë një salle trajnimi tradicionale. Akademia e Drejtësisë e ka të zhvilluar platformën e mësimi në distancë, e cila përmbushë të gjitha kërkesat për trajnime. Përparësitë e platformës janë ruajtja/kursimi i buxhetit të Akademisë, ulja e shpenzimeve që krijojnë pjesëmarrësit, kursimi i kohës dhe cilësia e lartë e trajnimeve.

Me rritjen e numrit të trajnimeve në platformë gjatë viti 2018 synohet ofrimi i mundësisë, që gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë në kohë të përshtatshme dhe të herëpashershme të vijojnë kurset trajnuese.

3.12 Menaxhimi i të dhënave

Të dhëna e shumta brenda Akademisë shtrojnë nevojën për krijimin e sistemit për menaxhimin e tyre. Mirëmbajtja dhe përditësimi i tyre është shumë i rëndësishëm sepse shfaqë aktivitetet dhe punën e Akademisë dhe lehtëson komunikimin ndërinstytucional dhe raportimin me KGJK-në, KPK-në, gjykatat dhe prokuroritë. Lidhur me këtë Akademia e Drejtësisë do të bëjë përpjekje që të krijojë kushte për avancimin e bazës së të dhënave.

4. Administrata, financat dhe shërbimet e përgjithshme

Departamenti i Administratës dhe Financave brenda kompetencave të veta përshinë shërbimet e përgjithshme dhe administrative, teknologjinë informative, burimet njerëzore, financat dhe prokurimit.

Fokusi i këtij departamenti do të jetë në hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore brenda kompetencës së vet në mbështetje të aktiviteteve që realizon Akademia e Drejtësisë.

4.1 Burimet njerëzore

AD aktualisht ka 25 pozita të miratuara, që nuk janë të mjaftueshme për të realizuar funksionet në mënyrë efikase, andaj kërkohet rritja e numrit të stafit për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve trajnuese. Pozitat e reja kryesisht duhet të jenë profesionale në zbatim të programeve trajnuese dhe pozita administrative të nevojshme për menaxhim dhe administrim të shërbimeve të përgjithshme.

Gjithashtu ngritja e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore është e nevojshme dhe realizohet përmes trajnimeve të ndryshme, të cilat orientohen varësisht nga niveli funksional i stafit. Në këtë kuadër, AD po ashtu do të vazhdoj bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare trajnuese që të siguroj programe të intershipit me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.

Gjatë viti 2018 do të bëhet riorganizimi i brendshëm konform akteve normative dhe nevojave të AD në realizimin e funksionit të saj.

4.2 Financat

Burim kryesor financiar i AD-së është buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme. AD përgatit kërkesën buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara dhe ka kapacitete të mjaftueshme për të vlerësuar koston reale për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetim.

Planifikimi buxhetor bëhet përmes shfrytëzimit të mekanizmave të ndryshëm dhe mjaft efikas. Planifikimi i mirë dhe ekzekutimi buxhetor duke respektuar rregullat ligjore në fuqi siguron realizimin e programeve të AD-së.

4.3 Prokurimi

Legjislacioni në fuqi që e rregullon fushën e prokurimit publik ka pësuar ndryshime, duke bërë centralizimin e prokurimit, që nënkupton zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe lidhjen e kontratave nga ana e AQP-së për AD-në. Me këtë ndryshon edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. AD do të siguroj që planifikimi i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave do të bëhet në harmoni me legjislacionin në fuqi të prokurimit.

4.4 Shërbime të përgjithshme dhe teknologji informative

Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme përfshihen të gjitha aktivitetet që mbështesin realizimin e funksioneve të AD-së, si: teknologjia informative, infrastruktura, furnizimet, transporti, mirëmbajtja, sistemi elektronik i furnizimeve, klasifikimi dhe arkivimi i dokumenteve.

Zbatimi i teknologjisë informative në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera përmes sistemit elektronik do të jetë një nder objektivat kryesore në fushën e teknologjisë informative. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike që posedon IGJK është një proces i vazhdueshëm i cili ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje.

5. Bashkëpunimi me partner strategjik

Mbështetja e programeve të trajnimeve praktike, programeve të shkëmbimit dhe vizitave studimore jashtë vendit paraqesin një aspekt të veçantë të zhvillimit profesional, ngritjes së shkathtësive menaxhuese dhe ndërpersonale të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe profesionistëve të tjerë gjyqësor dhe personelit të AD-së. Në këtë aspekt një kontribut të madh janë duke luajtur partnerët dhe donatorët e AD-së.

Shkëmbimi i përvojave në ngritje të performancës së tyre mbetet njëri nga synimet kryesore të këtyre programeve me karakter ndërkombëtarë. Ky shkëmbim sot mbetet kërkesë parësore qoftë përmes pjesëmarrjes në iniciativa, forume dhe rrjete me karakter regjional e më gjerë, qoftë përmes sjelljes së ekspertizave që mbulojnë fusha me deficit eksperience në vendin tonë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi AD do të vazhdoj të jetë pjesë aktive e angazhimeve në projekte të përbashkëta për zhvillim të gjyqësorit si nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, e po ashtu edhe nismave të ndryshme rajonale e më gjerë të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një sistemi gjyqësor profesional.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2018, AD do të fokusohet në realizimin e aktiviteteve tashmë të konfirmuar nga projekti i Binjakëzimit (Twinning), GIZ, JUFREX, EBRD, EULEX, UNHCR-CRPK, JSSP, iPROCEEDS, UNDP, PECK II dhe projekte tjera të financuar nga BE dhe donatorë tjerë që mbështesin sektorin e drejtësisë.

6. Plani për zbatimin e Planit të Punës së AD-së

Për zbatimin e planit të punës nevojitet përcaktimi i prioriteteve, aktivitetet kryesore me veprimet konkrete, afatet dhe indikatorët kryesor. Në funksion të zbatimit do të hartohen edhe dokumente tjera të cilat janë pjesë e programeve të cilat do të ndahen për përfituesit e Akademisë me të vetmin qëllim që ata të kenë mundësinë e pjesëmarrjes në programet të cilat janë me interes për punën e tyre. Pavarësisht asaj se me rastin e hartimit të planit të punës Akademia e Drejtësisë ka përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor e prokurorial ky plan mund të rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet sipas kërkesave dhe nevojave që dalin si pasojë e ndryshimeve legislative që mund të ndodhin në sistem.

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
1. Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm	Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme	PTV	Përcaktimi i kalendarit Angazhimi trajnuesve sipas listës Hartimi i agjendave dhe materialeve tjera trajnuese	Janar dhjetor	Listat e aplikuesve Agjendat e hartuara Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrësve
	Avancimi i sistemit të vlerësimit të trajnimeve	PTV	Ri shikimi dhe hartimi i formularëve	Janar shtator	Formularët e hartuar
	Përditësimi i kurrikulës trajnuese	PTV	Mbledhja dhe përpunimi i temave që do të integrohen-largohen nga kurrikula trajnuese varësisht prej kërkesave dhe nevojave trajnuese Takimi i Këshillit Programor	Janar dhjetor	Kurikula e përditësuar
	Hartimi i propozim programit trajnues për vitin 2019	Këshilli Programor	Mbledhja dhe përpunimi i temave që dalin si rezultat i vlerësimit të nevojave trajnuese	Shtator nëntor	Drafti i hartuar
	Organizimi i trajnimeve të detyrueshme	PTV	Koordinimi me KGJK dhe KPK për hartimin e listës së pjesëmarrësve	Janar Dhjetor	Agjendat e trajnimeve Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrësve
2. Trajnimi fillestar	Organizimi i trajnimeve për gjyqtarët e sapo emëruar	PTF	Realizimi i trajnimeve teorike Realizimi i trajnimeve praktike në gjykata dhe institucione jo gjyqësore	janar shtator	Raporti përfundimtar
	Hartimi i propozim programit të trajnimeve për prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VII	Këshilli Programor	Propozimi i draft programit trajnues Përcaktimi i kalendarit Koordinimi me trajnuesit dhe mentorët Përditësimi i moduleve trajnuese	Varet nga procesi i dekretimit	Drafti i hartuar
	Organizimi i trajnimeve për prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VII	PTF	Realizimi i trajnimeve teorike Realizimi i trajnimeve praktike në prokurori dhe institucione jo gjyqësore	Varet nga procesi i dekretimit	Raportet e trajnimeve Raporti përfundimtar
	Hartimi i propozim programit sipas metodologjisë bazuar në rasteve	Këshilli Programor	Hartimi i doracakut për zbatimin e metodologjisë të bazuar në raste Punëtori për zhvillimin e moduleve	Janar Dhjetor	Draft programi i hartuar

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
1. Hulumtimet dhe publikimet	Publikimi i revistës Opinio Juris	PHP	Shpallja publike Përcaktimi i fushave me prioritet për publikim Mbledhja e punimeve Redaktimi dhe vlerësimi punimeve	Janar dhjetor	Opinio juris e publikuar
	Publikimi i revistës Juticia për prokurorët e sapo emëruar dhe i Juticia gjyqtarët e sapo emëruar	PHP	Mbledhja e punimeve Redaktimi dhe vlerësimi punimeve	Shkurt Mars-Qershor	Justicia për prokurorët e sapo emëruar e publikuar Justicia për gjyqtarët e sapo emëruar e publikuar Raporti përfundimtar
	Publikimi i “Praktikës gjyqësore e Gjykatës së Apelit e fokusuar në lëndët që kthehen në rigjykim”	PHP	Përkthimi i materialit Dizajnimi dhe shtypja Monitorimi i procesit të shtypjes	Janar-Mars	Përmbledhja e publikuar
	Publikimi i dokumenteve periodike, moduleve , programeve dhe buletinit të Akademisë	PHP	Përgatitja teknike e materialit për shtyp Monitorimi i procesit të dizajnit dhe të shtypjes	Janar Dhjetor	Modulet trajnuese të publikuara Raporti vjetor 2017 i publikuar Programi trajnues për vitin 2019 i publikuar Plani i punës për vitin 2019 i publikuar Buletini i publikuar
	Zbatimi i mekanizmave për vlerësim të nevojave për trajnime dhe përpunimi i të dhënave	PHP	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga mekanizmat e zhvilluar	Qershor tetor	Përmbledhje e rekomandimeve për draftin e programit trajnues

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
	Hulumtimi	PHP	Identifikimi i nevojave për hulumtime Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë Mbledhja e të gjeturave nga hulumtimi	Janar Dhjetor	Rezultatet e hulumtimit të publikuar
	Rritja e numrit të koleksioneve të bibliotekës së Akademisë	PHP	- Identifikimi për titujt të ri në fushën juridike - Abonimi në databaza ligjore	Janar dhjetor	- Përditësimi i katalogut të titujve të bibliotekës - Abonimi në data bazat ligjore përmes ABEK dhe data bazave tjera
4. Organizimi i trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	Organizimi i trajnimeve	PTV	Përcaktimi i kalendarit Angazhimi i trajnuesve Hartimi i agjendave dhe materialeve trajnuese	Mars - dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
	Hartimi i kurrikulës së trajnimeve 2019	PTV	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përpunimi dhe vlerësimi i të gjeturave ▪ Tryeza, punëtori dhe takime me ekspertë 	Qershor - tetor	Drafti i hartuar
5. Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Organizimi i trajnimeve	PTV	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Angazhimi i trajnuesve ▪ Hartimi i moduleve trajnuese Përcaktimi i përfituesve Përcaktimi i kalendarit Hartimi i agjendave dhe materialeve trajnuese	Prill- Dhjetor	Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrësve
	Hartimi i draftit të programit 2019	PTV	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përpunimi dhe vlerësimi i të gjeturave ▪ Tryeza, punëtori dhe takime me ekspertë 	Qershor- Tetor	Drafti i hartuar
6. Zbatimi i Rregullores për trajnues dhe mentor	Procedura për zgjedhje e trajnuesve	AD	Shpallja publike për përzgjedhje të trajnuesve Komisioni për vlerësimin e dokumentacionit Konsultimi i listës me Këshillin Programor Miratimi i listës nga Këshilli Drejtues	Janar - Mars	Lista e trajnuesve e miratuar
	Organizimi i trajnimeve për trajnues	DP	Identifikimi i pjesëmarrësve Përcaktimi i kalendarit <ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i agjendave dhe materialeve trajnuese 	Shkurt -Dhjetor	Raportet e trajnimeve Listat e pjesëmarrësve

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
7. Trajnimet nga distanca	Organizimi i trajnimeve nga distanca	DP	Njoftimi i pjesëmarrësve për kurset online Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i materialeve trajnuese	Janar -Dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
	Hartimi i kurseve të reja	DP	Punëtori me ekspertët dhe stafin e Akademisë Adaptimi dhe konvertimi në platformë	Janar –Mars Mars-Nëntor	Kurset online
8. Planifikimi strategjik i AD-së	Hartimi i planit strategjik	AD	Punëtori me KGJK, KPK, kryetar, kryeprokuroor dhe projektin e binjakëzimit Përfshirja e rekomandimeve Tryezë pune me mekanizmat e brendshëm të Akademisë Miratimi i planit strategjik	Shkurt Shkurt-Maj Qershor Korrik -shtator	Plani strategjik i hartuar
	Hartimi i programit të punës 2019	AD	Punëtori për hartimin e planit të punës	Nëntor	Plani i punës i hartuar
9. Bashkëpunimi dhe partneriteti	Memorandumet e bashkëpunimit	AD	Zbatimi i memorandumëve në fuqi Arritja e memorandumëve të reja	Janar dhjetor	Marrëveshjet e nënshkruara/zbatuara
	Zbatimi i projektit me donator	AD	Koordinimi për zbatimin e projekteve	Janar -dhjetor	Raportet e punës
	Koordinimi me institucione vendore dhe me donatorë	AD	Takime të rregullta	Janar -dhjetor	Raportet Marrëveshje bashkëpunimi
10. Takimet e Këshillit Drejtues	Udhëheqja dhe mbikëqyrja e punës së Akademisë	AD	Takime	Janar – Dhjetor	Agjenda Procesverbali Vendimet Aktet normative të miratuara Miratimi i Raportit vjetor 2017 Miratimi i Programit të Punës 2019 Miratimi i listës së trajnuesve dhe mentorëve Miratimi i Planit Strategjik Miratimi i Projekt -Buxhetit

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
11. Aktet normative	Rishikimi i akteve normative ekzistuese	AD	Vlerësimi dhe efekti i ndryshimeve të reja ligjore Rishikimi i akteve	Janar-Dhjetor	Aktet e ndryshuara
	Miratimi i akteve të reja	Këshilli Drejtues Drejtori	Identifikimi i nevojave për akte normative të reja Hartimi i akteve	Janar – Dhjetor	Aktet e miratuara
12. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit	Vlerësimi dhe planifikimi buxhetor 2019-2021	DAF	Vlerësimi i nevojave Përgatitja e KASH-it 2019-2021 Përgatitja e buxhetit 2019 dhe vlerësimet 2020-2021 Regjistrimi në BDMS dhe PIP sistem	Mars – prill Maj - Korrik	KASH-i dhe buxheti i hartuar
	Zbatimi i buxhetit sipas planifikimit	DAF	Përgatitja e Rrjedhës së Parasë Përgatitja e planit detaj të zotimit dhe shpenzimeve Regjistrimi i shpenzimeve në bazën e të dhënave dhe SIMFK Përgatitja e raporteve financiare	Janar - dhjetor	Zbatimi i buxhetit sipas planifikimit dhe ligjit
	Kontrolli financiar dhe menaxhimi i rrezikut	DAF	Përgatitja e formularëve për vetëvlerësim Auditimi Përgatitja dhe zbatimi i planit për zbatim të rekomandimeve të ZAP Hartimi i regjistrit të rreziqeve 2018	Janar - Dhjetor	Marrëveshjet e bashkëpunimit Raportet e auditimit Regjistri i rreziqeve i hartuar
13. Ngritja e shkathtësive profesionale të burimeve njerëzore	Planifikimi i personelit duke përfshirë edhe pozitat e reja të nevojshme	DAF	Rishikimi i detyrave të punës Përkrahimi i detyrave për pozitat e nevojshme Zhvillimi i procedurave të rekrutimit	Janar - Dhjetor	Planifikimi i realizuar
	Trajnime dhe programe inetershipi për staf	DAF	Vlerësimi i nevojave Propozimi i programit	Janar - Dhjetor	Raportet e trajnimeve
	Vlerësimi i performances së punës	AD	Planet e punës Takimet Përgatitja e formularëve	Dhjetor	Vlerësimi i përfunduar

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

Prioriteti	Aktiviteti	Njësia përgjegjëse	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
14. Zhvillimi i prokurimit sipas nevojave të programeve	Planifikimi, zbatimi i prokurimit, dhe menaxhimi i kontratave sipas nevojave dhe procedurave ligjore	DAF	Identifikimi i nevojave Përgatitja e planit vjetor Përgatitja e raporteve të prokurimit Përcaktimi i specifikacioneve Çaktimi i menaxhereve të kontratave	Janar-Dhjetor	Planifikimi i realizuar
15. Shërbimet e përgjithshme	Avancimi dhe zbatimi i teknologjisë informative	DAF	Mirëmbajtja e pajisjeve harduerike dhe softuerike Azhurnimi i listës me softuerëve të aplikueshëm Sigurimi i të dhënave përmes sistemeve jashtë AD-së Krijimi i aplikacioneve të reja sipas nevojës Mirëmbajtja e web dhe aplikacioneve tjera Avancimi i bazës së të dhënave	Janar Dhjetor	Plani i realizuar
	Plotësimi dhe ndryshimi i regjistrimit të aseteve	DAF	Regjistrimi i aseteve të reja Inventarizimi Vlerësimi Komisionet Azhurnimi i regjistrimit	Janar Dhjetor	Regjistri i plotësuar dhe ndryshuar
	Ndërtesa e AD-së	AD	Koordinim i aktiviteteve me MAP për projektimin e ndërtesës së AD-së	Korrik	Plani ideor i hartuar
	Krijimi i arkivës dhe elektronik të arkivit	DAF	Sigurimi i kushteve për arkiva Krijimi i bazës së të dhënave Organizimi i arkivit Regjistrimi në bazën e të dhënave	Janar Dhjetor	Raportet nga baza e të dhënave
	Avancimi i shërbimeve të logjistikes	DAF	Identifikimi i nevojave dhe blerja e pajisjeve sipas nevojës Mirëmbajtja e pasurive dhe objektit Sigurimi i kushteve teknike sipas nevojës me furnizime dhe transport Regjistrimi në bazën e të dhënave dhe E-pasuri	Janar Dhjetor	Raportet e gjeneruara nga baza e të dhënave

7. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban sfida dhe rreziqe të shumta, ndër të cilat theksojmë:

- **Zbatimi i funksioneve të dala nga transformimi** - Transformimi i IGJK-së në Akademi të Drejtësisë, ndikon drejtpërdrejtë në funksionimin të AD-së për shkak se ka menaxhment të zgjedhur rishtazi, përgjegjësi të reja shtesë dhe riorganizim i brendshëm.
- **Mungesa e objektit të AD-së** – Akademia e Drejtësisë, veprimtarinë e saj e ushtron në një objekt privat me qira i cili nuk i plotëson infrastrukturën e nevojshme për realizimin e mandatit të saj.
- **Buxheti** – Sigurimi i buxhetit sipas planifikimeve të përcaktuara në kryerjen e funksionit të saj paraqet sfida për AD-në.
- **Personeli** – për të realizuar funksionet e saja AD i duhet personel i kualifikuar dhe profesional, gjë të cilën vlerësojmë se është përmbushur në masën më të madhe. Megjithatë sfida e personelit paraqitet në dy drejtime; e **para**, në mungesën e motivimit financiar, (brenda 7 viteve janë larguar 7 zyrtarët më të lartë profesional dhe drejtues), e cila vë në rrezik përmbushjen e objektivave, dhe e **dyta**, nevoja për ngritjen e kapaciteteve profesionale për të zbatuar funksionet e reja, standardet dhe praktikat bashkëkohore në fushën e trajnimit gjyqësor.
- **Bashkëpunimi** – Akademia e Drejtësisë promovon bashkëpunimin ndërinstytucional me institucionet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Ky bashkëpunim duhet të jetë i ndërsjellë, pasi që përfitues të trajnimeve janë gjyqtarët, prokurorët, stafi administrativ gjyqësor e prokurorial si dhe profesionistët tjerë.
- **Legjislacioni** – Ndryshimet legjislative të cilat kanë ndikim direkt dhe indirekt në punën e Akademisë paraqesin sfida të mëtutjeshme për realizimin me sukses të objektivave.

Akademia e Drejtësisë do të hartoj një regjistër të veçantë ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante.

8. Përfundimi

Krijimi i sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, dhe efikas është i një rëndësie të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjykimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të madh në drejtim të ngritjes së shkathtësive profesionale, ndërdisiplinore dhe personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky plan i punës është në funksion të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinore të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë të sistemit të drejtësisë drejt zhvillimit sipas standardeve bashkëkohore.

Me këtë rast shprehim falënderimin tonë të veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e tij si dhe ata që do të përfshihen dhe mbështesin zbatimin e tij gjatë vitit 2018

<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr. Muharrem Fejza p.n -Prishtinë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. Muharrem Fejza p.n -Prishtinë